NJOFTIM PUNËSIMI	
Prezantimi i Shoqërisë Rajonale UK	Sh.a. Ujësjellës Kanalizime Rajoni Durrës është themeluar më 31.08.2022 sipas VKM nr. 302, dt. 11.05.2022 "Për Politikat Kombëtare për riorganizimin e sektorit të furnizimit me ujë dhe të largimit, trajtimit dhe përpunimit të ujërave të ndotura". Shoqëria Rajonale UK është një institucion profesional i licencuar për ofrimin e shërbimeve bazike të shërbimeve të furnizimit me ujë të pijshëm dhe kanalizimeve. Ajo i shërben bashkisë Durrës, Shijak, Kavajë, Rrogozhinë dhe Krujë.Aktualisht Shoqëria Rajonale UK po kërkon të punësojë për një vend pune**: Faturues/e pranë Sektorit të Leximit në Njësinë Operative Durrës** nisur nga data më e afërt. Punëmarrësi i ri do të jetë përgjegjës për leximin e rregullt (mujor) të matëseve të klientëve që ndodhen në zonën që mbulon. Detyrat përfshijnë gjithashtu kryerjen e verifikimeve në terren në funksion të kërkesave për lidhje të reja dhe/ose lidhje të kontratave të reja me qëllim parandalimin e abuzimeve dhe lidhjeve të dyfishta.
Detyrat dhe përgjegjësitë e punës:	• Gjatë leximit të matësit, kryen verifikime mbi gjendjen e matësit në lidhje me funksionimin e tij, vulosjen e tij, ndërhyrjeve të paligjshme dhe problematikave të tjera të ndryshme si rrjedhje, etj. • Rezultatet e verifikimeve sipas rastit dhe procedurave të miratuara i regjistron dhe raporton si anomali si dhe mban përgjegjësi për mos-raportimin apo raportimin qëllimisht të gabuar të anomalive. • Në fund të ditës dorëzon pranë Përgjegjësit të Leximit, listat e plotësuara të leximit së bashku me regjistrin e anomalive (për zonat që nuk mbulohen me PDA). • Siguron faturat nga Përgjegjësi i Leximit dhe vijon me shpërndarjen e faturave tek klientët që ndodhen në zonën që mbulon. • Kryen verifikime të konsumit dhe matësit në terren sipas udhëzimeve të Zyrës së Faturimit në NjO dhe Drejtorisë së Shitjes në Drejtorinë e Përgjithshme.

	• Është i detyruar të vrojtojë, kontrollojë të gjithë përdoruesit e zonës së tij për të mos lejuar asnjë konsumator pa faturim si pasojë e mos-lidhjes së kontratës.
Kualifikimet e synuara dhe dokumentacioni:	• Eksperienca pune të mëparshme. • Librezë e Punës • Certifikatë Familjare • Fotokopje e Kartës së Identitetit, Pasaportës • Dy fotografi • Fotokopje e Dëftesës me listën e notave e noterizuar • Dëshmi Penaliteti • Raporti Mjekësor • Vërtetim Vendbanimi
Kushtet e punës:	• Mundësinë për të punuar në një kompani të ngritur. • Mundësinë për të krijuar eksperiencë në kompani.

- Nëse jeni të interesuar dhe besoni se ju përmbushni të gjitha kërkesat për pozicionin e punës, ju lutemi aplikoni me letër përcjellëse, CV-në dhe dëshmi të kualifikimeve arsimore dhe profesionale (dëftesë, certifikata, etj.) deri më datë 04.11.2026, pranë Protokollit të Dr.Përgjithshme Shoqërisë UK.Rajoni Durrës. Për çdo pyetje/paqartësi, ju lutemi kontaktoni në emailin zyrtar.